



HUB Rinor
BALLKANI PERENDIMOR DHE TURQIA

MANUALI I PRAKTIKAVE MË TË
MIRA TË PUNËSIMIT TË TË
RINJVE, DHE ORGANIZATAVE TË
SHOQËRISË CIVILE NË PUNËN
ME TË RINJTË

■ I N F O R M A C I O N

Manuali i praktikave më të mira punësimit të të rinjve dhe organizatave të shoqërisë civile në punën me të rinjtë është përgatitur nga:

Community Volunteers Foundation TOG (Turqi).

Fondacioni Ana dhe Vlade Divac (Serbi)

Mladiinfo International (Maqedonia e Veriut)

OJF "Prima" (Mali i Zi)

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (Shqipëri)

Botuesi: Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim

Rruga Elbasanit, Kompleksi PARK GATE, Hyrja nr.3, Kati 10, Ap. 71 / 73,
Tiranë, Shqipëri

Nr. i telefonit: +35542254881

Faqe interneti: www.partnersalbania.org

■ A U T O R I :

Milica Skiljevic

■ R E D A K T U A R N G A :

Bojana Jevtovic

■ B A S H K A U T O R Ë :

Ariola Memia

Aylin GüLüm

Katarina Vukadinovic

Jelena Jovanovic

Vlora Rechica

Natasha Dimova

■ K O N T R I B U E S I T :

Gülçin Yüce

Jonida Alite

Marjan Icoski

2021



Ky dokument është përgatitur me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi ekskluzive e Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

A H Y R J E

“Manuali i praktikave më të mira punësimit të të rinjve dhe organizatave të shoqërisë civile në punën me të rinjtë” është një udhëzues gjithëpërfshirës, sistematik për organizatat e shoqërisë civile (OSHC-të), të rinjtë NEET, gratë dhe grupet e tjera të marginalizuara të cilët janë të orientuar drejt tregut të punës.

Manuali është hartuar për të shërbyer si një udhërrëfyes dhe udhëzues për organizatat rinore dhe OSHC-të e tjera të interesuara për të ofruar punësim dhe modele biznesi për përmirësimin e situatës së të rinjve NEET në komunitetet e tyre përkatëse.

Ky dokument bazohet në gjetjet e një studimi krahasues, të kryer në Shqipëri, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut, Serbi dhe Turqi. Analiza përfshin një hulumtim dytësor të shembujve të zbatueshëm të përdorur në të gjitha vendet anëtare të BE-së, dhe mbledhjen e të dhënave dhe shembujve të praktikave të mira nga organizatat përkatëse të shoqërisë civile nga vendet e përmendura më sipër, të cilat janë pjesë e projektit “WB&T for EmploYouth”.

Projekti synon të kontribuojë në përforcimin e bashkëpunimit rajonal, demokracitë pjesëmarrëse dhe procesin e afrimit të BE-së me Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë në fushën e punësimit të të rinjve me një fokus në krijimin e zgjidhjeve bazuar në informacion të qendrueshëm, në mënyrë që të përmirësojë politikën e punësimit të të rinjve në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi; rritjen e kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile (OSHC-ve) për të udhëhequr dhe promovuar zgjidhje novatore për punësimin e përmirësuar të të rinjve NEET në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi; dhe të rrisë angazhimin dhe ndikimin e OSHC-ve në rritjen e ndërgjegjësimin publik për punësimin e të rinjve në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi.

Projekti mbështetet nga Komisioni Evropian, si pjesë e përpjekjeve për të përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme marrëdhëniet e institucioneve me të rinjtë. “WB&T for EmploYouth” zbatohet nga pesë organizata rinore nga vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqia, specifiku: Fondacioni Ana dhe Vlade Divac (Serbi), Organizata Prima (Mali i Zi), Mladiinfo International (Maqedonia e Veriut), Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (Shqipëri) dhe Community Volunteers Foundation (Turqi).

HUB-i Rinor për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë është një rrjet i përbërë prej 20 organizatash rinore nga Ballkani Perëndimor dhe Turqia. HUB-i Rinor u themelua fillimisht në vitin 2016 për të mbledhur të dhëna mbi pozicionin e të rinjve, për të monitoruar dhe ndjekur përfshirjen e të rinjve në politikën dhe proceset e reformave në secilin prej vendeve. HUB-i Rinor mbështet ndryshimet e politikave në lidhje me pozicionin e të rinjve në mënyrë që të arrihet një pjesëmarrje më e lartë e të rinjve në jetën politike, ekonomike dhe shoqërore në secilin vend. HUB-i Rinor u themelua fillimisht në vitin 2016 nga pesë organizata: Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (Shqipëri), Mladiinfo International (Maqedonia e Veriut), Organizata Prima (Mali i Zi), Fondacioni Ana dhe Vlade Divac (Serbi) dhe TOG (Turqi).

Për më shumë informacion mbi punën e rrjetit dhe modelin e HUB-it Rinor: <https://youthwbt.eu/>

Koncepti i NEET i referohet një grupi të larmishëm individësh (të rinj) që nuk janë të punësuar, nuk ndjekin shkollën apo trajnime. Më saktësisht, ajo u referohet të rinjve të papunë dhe joaktivë të cilët nuk janë regjistruar në arsimin formal ose programet e arsimit joformal.

Termi NEET u shfaq për herë të parë në vitet 1990, në diskutimet e politikave në Mbretërinë e Bashkuar lidhur me nevojën për të integruar sërish të rinjtë e moshës 16-18 vjeç, të cilët kishin braktisur arsimin, por nuk kishin kaluar në tregun e punës. NEET-ët janë përmendur në mënyrë specifike për herë të parë në diskutimet e politikave evropiane në nismën kryesore të Evropës 2020 "Rinia në lëvizje". Termi është zgjeruar për të përfshirë grupmoshat 15-24 dhe më vonë grupmoshat 15-29. Tashmë është integruar në qendër të ligjërimit të politikave të Komisionit Evropian, Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Bashkimit Evropian. [1]

Megjithëse, koncepti i NEET fillimisht shërbeu si një mjet për të kuptuar se si situatat NEET ndikojnë tek individë, në ditët e sotme ai ka evoluar dhe shpesh konsiderohet si një tregues se si situatat NEET ndikojnë në shoqëri, ekonomi, dhe tregun e punës.

Ndryshimet midis të rinjve të cilët janë të papunë ose joaktivë dallohen nga mosha, historiku familjar, karakteristikat personale, statusi socio-ekonomik, niveli arsimor etj. Kuptimi i këtyre barrierave është thelbësor, dhe i kombinuar me kontekstin specifik të komunitetit, dhe njohuria e përgjithshme e zhvillimit të së rinjve dhe nevojat arsimore mund të shërbejnë në zhvillimin e programeve dhe masave të përshtatshme dhe cilësore të mbështetjes.

RROLI I ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE

Pas krizës ekonomike dhe veçanërisht krizës së papunësisë së të rinjve në Evropë, si komuniteti kërkimor ashtu edhe qeveritë u përqendruan në ekzaminimin e mënyrave të reja të të kuptuarit dhe analizimit e pikave të dobëta të së rinjve në tregun e punës.

Në ndryshimin e shpejtë të tregut të punës, të rinjtë po përballen me mungesën e aftësive që mund t'i ndihmojnë ata të përshtaten me kërkesat e tregut të punës dhe të kalojnë me sukses nga sistemi arsimor në tregun e punës. Të rinjtë në Evropë dhe veçanërisht të rinjtë në Ballkanin Perëndimor (BP) dhe Turqia janë pjesë e përqindjes së lartë të popullsisë që është e papunë dhe nuk ka njohuritë dhe aftësitë e nevojshme. Meqenëse sistemi i arsimit formal nuk është i mjaftueshëm për trajtimin e këtyre çështjeve, metodat joformale të të mësuarit kanë një rëndësi të konsiderueshme në fuqizimin e mëtejshëm të së rinjve për tregun dinamik të punës.

Duke pasur parasysh kompleksitetin e papunësisë së të rinjve, përgjigjet e qarta dhe cilësore kërkojnë bashkëpunimin e ndërsjellë të të gjithë aktorëve. Organizatat e shoqërisë civile (OSHC-të) kanë një histori të gjatë në hartimin dhe zbatimin e trajnimeve dhe shërbimeve me cilësi të lartë dhe novatore për të rinjtë, të cilat kontribuojnë së bashku në përmirësimin e aftësive të punësueshmërisë së të rinjve.

OSHC-të kanë një rol veçanërisht të rëndësishëm në prekjen e të rinjve NEET, veçanërisht ata të shtresave në nevojë të cilët shpesh nuk janë përfshirë sa duhet në programet qeveritare.

Ndryshe nga programet qeveritare dhe masat e politikave, organizatat e shoqërisë civile mund të arrijnë më lehtë popullatën NEET dhe t'i angazhojnë ata në programet e tyre. Ky fleksibilitet mundëson qasje të përshtatur në programet e hartimit të programeve bazuar në nevojat e nëngrupeve specifike të së rinjve.

Përforcimi i bashkëpunimit ndërmjet organizatave të shoqërisë civile dhe hartimi i zgjidhjeve të përbashkëta në fushën e punësimit të së rinjve është i një rëndësie të madhe për rajonin. Bashkëpunimi mundëson shkëmbimin e njohurive dhe praktikave të mira për uljen e shkallës së papunësisë së të rinjve. Ai rrit përfshirjen e të rinjve në projekte bashkëpunimi dhe mbështet marrjen e aftësive përkatëse për integrimin e të rinjve në tregun e brendshëm të punës dhe atë të BE-së. Në përgjithësi, njohja e OSHC-ve si partnerë të barabartë me institucionet publike në politikën dhe proceset e vendimmarrjes mundëson politikën e reformave që korrespondojnë me nevojat e qytetarëve të rinj dhe krijojnë terrenin për pjesëmarrje aktive dhe jetë cilësore të pavarur për të gjithë qytetarët.

[1] Eksplorimi i shumëllojshmërisë së NEET-ëve, Përmbledhje ekzekutive, Eurofound: https://www.eurofound.europa.eu/sites/default/files/ef_publication/field_ef_document/ef1602en_1.pdf vlerësuar më: 11 shkurt 2021

SHEMBUJ TË PRAKTIKAVE TË MIRA NË BE

Lloji i aktivitetit	Udhëzime dhe informacione për karrierën dhe zhvillimin e aftësive
Shtegu im i karrierës - Fondacioni Edu Compass	
Emërtimi: nëngrup/NEET, OSHC etj.	Nxënësit e komunitetit rom dhe bullgar nga klasa e 11-të dhe 12-të (theksi tek të diplomuarit) nga një zonë e largët e qytetit të Sofjes, Bullgari
Objektivat e aktivitetit	Ndryshimi i perceptimit mbi mundësitë e punësimit në dispozicion; Përmirësimi i aftësive të punësimit – zhvillimi i aftësive teknike dhe personale; Kuptim i qartë i tregut të punës dhe mundësive.
Përshkrimi hap pas hapi	<p>Programi u zhvillua dhe u ofrua si një kurs 5-javor për 40 studentë. Aktivitetet kryesore dhe mbështetja e ofruar përfshinin:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kuptimi i qartë dhe zhvillimi i përshtatjeve më të mira në karrierë për secilin student bazuar në qëndrimet, interesat dhe personaliteti; 2. Zhvillimi i një aftësie teknike – dizajn, kodim, etj., bazuar në stilet personale të të mësuarit; 3. Zhvillimi i aftësive kryesore transformuese si vendosja e qëllimit, planifikimi, vetë-prezantimi, mendimi kritik, krijimtaria, qendrueshmëria. <p>Përmes këtij kursi, të rinjtë zhvillojnë një profil individual dhe një udhërrëfyes për rrugët specifike të karrierës. Ata janë të motivuar të eksplorojnë rrugët e zgjedhura dhe me përpjekje personale të kuptojnë dhe kenë pritshmëri të qarta për karrierën e zgjedhur. Rezultati i kursit është një plan personal i karrierës me hapa specifike në mënyrën se si të arrihet dhe të ruhet në profilin e zgjedhur të karrierës (arsimi zyrtar, aftësitë e vetë-prezantimit, etj.).</p>
Rezultatet	Mundësi të barabarta për studentët nga zonat e largëta dhe komunitetet e pafavorizuara; 7 nga 10 persona gjetën punë ose vazhduan arsimin pas përfundimit të kursit.
Burimet e disponueshme:	https://edu-compass.com/

Lloji i aktivitetit	Shkollat që ofrojnë një mundësi të dytë
Qendra e Trajnimit të Komunitetit Blanchardstown - Bordi i Edukimit dhe Trajnimit në Dublin dhe Dún Laoghaire	
Emërtimi: nëngrup/NEET, OSHC etj.	Të rinjtë e moshës 15-21 vjeç që braktisin herët shkollën, pa kualifikime
Objektivat e aktivitetit	Këto programe ofrojnë përgatitje profesionale dhe trajnime për aftësitë për jetën për personat që e braktisin herët shkollën dhe të rinjtë vendas. Programi jep mundësinë për të mësuar aftësi të reja dhe për të marrë njohuritë dhe përvojën e nevojshme për punësim, trajnim të mëtejshëm ose arsimim të vazhdueshëm. Ai synon të ofrojë këshilla të integruara; udhëzime dhe akses në mundësitë e zhvillimit personal, duke ndihmuar kështu të rinjtë të bëjnë një kalim të qetë në moshën e rritur dhe në jetën profesionale.
Përshkrimi hap pas hapi	<ul style="list-style-type: none"> - Kualifikimet profesionale - Përvojë pune në profesionin e zgjedhur - Këshillim karriere për përgatitjen e të rinjve për tregun e punës - Mbështetje financiare (bursa për nxënësit dhe mbulim i shpenzimeve tëudhëtimeve gjatë trajnimeve). <p>“Shkolla e mundësive të dyta” është një ambient i qetë dhe i vogël (maksimumi 40 nxënës) i zhvilluar për t'i kushtuar vëmendje çdo nxënësi. Lëndët mësohen me rradhë, në mënyrë që studentët të mos ngarkohen me të gjitha lëndët në të njëjtën kohë. Provimet janë vlerësime dhe studentët i nënshtrohen atyre kur ata ndihen gati. Pasi studentët të përfundojnë kursin, ata bëhen pjesë e tregut të punës ose do të vijojnë me arsimin e mëtejshëm.</p> <p>Në këtë proces, atyre u ofrohet këshillim për karrierë, vizita në kolegje, informacione për karrierën, kërkim për punë dhe mbështetje në drejtim të eksperiencave të punës.</p>
Burimet e disponueshme:	http://dlctc.ie/# https://blanchardstownctc.ie/

Lloji i aktivitetit**Qasje më e mirë në arsimin universitar – Sigurimi i mbështetjes për studentët me nevoja ndryshe dhe për ata nga shtresat e pafavorizuara****Shoqata për Akses në Arsimin e Lartë dhe Aftësinë Ndryshe - AHEAD**

Emërtimi: nëngrup/NEET, OSHC etj.	Studentët dhe të diplomuarit me aftësi ndryshe
Objektivat e aktivitetit	Krijimi i mjediseve gjithëpërfshirëse në arsim dhe punësim për personat me aftësi ndryshe.
Përshkrimi hap pas hapi	<p>AHEAD ka zhvilluar shërbime komplekse dhe gjithëpërfshirëse për të rinjtë e interesuar që dëshirojnë të kalojnë drejt arsimin universitar dhe/ose të diplomuarve, të cilët kanë një lloj aftësie ndryshe dhe ju nevojitet informacion shtesë dhe mbështetje në mënyrë që të kenë akses të plotë dhe të barabartë në arsimin universitar.</p> <p>Programet e tyre janë të ndara në seksione:</p> <ul style="list-style-type: none">- Informacione mbi karrierën dhe informacione akademike, për studentët e ardhshëm mbi skemat e mbështetjes në dispozicion;- Burimet e disponueshme për studentët në kolegje, duke filluar nga mbështetja arsimore, mundësitë e financimit dhe shërbimet në dispozicion brenda institucioneve arsimore;- Këshillim për karrierë;- Këshillim për kërkimin e punës;- Informacion në lidhje me legjislacionin lidhur me punën;- Grante të disponueshme për punonjësit me aftësi ndryshe;- Trajnime për aftësitë personale "Think twice".
Burimet e disponueshme:	<p>https://www.ahead.ie/accessingcollege</p> <p>https://www.ahead.ie/student</p> <p>https://www.ahead.ie/graduate</p>

Lloji i aktivitetit	Programi i punësimit
Willing Able Mentoring (WAM)	
Emërtimi: nëngrup/NEET, OSHC etj.	Të diplomuarit me aftësi ndryshe
Objektivat e aktivitetit	Qasja në tregun e punës për të diplomuarit me aftësi ndryshe. Ndërtimi i kapaciteteve të punëdhënësve lidhur me integrimin e personave me aftësi ndryshe në vendin e punës.
Përshkrimi hap pas hapi	<p>Programi WAM është projektuar për të ofruar vende pune me pagesë për të diplomuarit me aftësi ndryshe si dhe për të përmirësuar politikat dhe procedurat e brendshme të punëdhënësve në rekrutim në mënyrë që të sigurojnë një trajtim të drejtë dhe të barabartë bazuar në aftësitë e punonjësve.</p> <p>Katër komponentët kryesorë të programit janë:</p> <p>Rekrutimi – një qasje gjithëpërfshirëse</p> <p>Vlerësimi i Nevojave – një proces konsultativ i krijuar për t’i ofruar të diplomuarit të zgjedhur, pra praktikantit të zgjedhur, mbështetjen dhe mjetet e përshtatshme të nevojshme në mënyrë që të përfundojnë me sukses tranzicionin drejt vendit të punës.</p> <p>Këshillimi – një proces mësimi i dyanshëm, i zhvilluar për të ofruar një hapësirë të sigurt për praktikantin për të reflektuar rreth përvojës dhe për t’u lidhur me mentorin e zgjedhur në vendin e punës.</p> <p>Marrëdhëniet – përfshirja sociale sipas rendit poshtë-lart.</p> <p>Të gjithë “praktikantët” i nënshtrohen një praktike pune bazuar në kualifikimet e tyre dhe marrin trajnime për aftësitë përkatëse të rëndësishme për aspektet e përgjithshme të punësimit, dhe përmes kursit të programit të praktikës për mbështetje të vazhdueshme brenda vendit të punës.</p>
Rezultatet	Duke filluar që nga viti 2005, Programi WAM ka siguruar gati 500 vende pune për të diplomuarit me aftësi ndryshe në disa nga kompanitë më të mëdha të Irlandës.
Burimet e disponueshme:	https://www.ahead.ie/waminfopack

Lloji i aktivitetit	Trajnim dhe mbështetje të dedikuara për sipërmarrjen
---------------------	------------------------------------------------------

Sipërmarrja kolektive në bashkëpunim – Co-Actions

Emërtimi: nëngrup/NEET, OSHC etj.	Përfituesit e papunë
Objektivat e aktivitetit	Programi ofron mbështetje në trajnimin e përfituesve për krijimin e bizneseve të reja, dhe më tej mbështetjen e tyre në zhvillimin dhe zgjerimin e biznesit të tyre.
Përshkrimi hap pas hapi	<p>Programi i mbështetjes ndahet në tre faza.</p> <p>1. Trajnim dhe këshillim mbi sipërmarrjen nga anëtarët e kooperativës Së pari, të sapoardhurit që janë të interesuar t'i bashkohen kooperativës, lidhin një kontratë ligjore e cila përcakton fushën e shërbimeve që do të sigurohen për krijimin e biznesit të tyre. Në këtë mënyrë, të gjithë të sapoardhurit vazhdojnë të marrin pagesën e tyre të papunësisë që lehtëson kalimin dhe u mundëson atyre të përqendrohen në zhvillimin e biznesit të tyre. Të gjithë anëtarët e kooperativës marrin pjesë në programin e trajnimit dhe ndihmojnë sipërmarrësit që fillojnë të zhvillojnë aftësitë e tyre sipërmarrëse, dhe i këshillojnë ata në lidhje me strategjitë e biznesit, buxhetet dhe strategjitë e komunikimit.</p> <p>2. Kalimi nga faza e zhvillimit të biznesit në fazën bashkëpunëtor-punonjës-sipërmarrës Të gjithë sipërmarrësit mbështeten dhe rriten falë përpjekjeve të tyre sipërmarrëse. Dallimi kryesor është se në këtë fazë ata nuk marrin fitime nga shitjet e tyre. Të gjitha të ardhurat vendosen mënjanë në një "fond" deri në momentin kur fitojnë qendrueshmëri financiare dhe mund të përdoren pasi të fitojnë të ardhura të mjaftueshme për të siguruar pagën e tyre mujore. Të gjithë pjesëmarrësit kanë mundësinë të bëhen aksionerë në kooperativë dhe të kontribuojnë financiarisht në mënyrë që të mbështesin stafin e përhershëm dhe që kooperativa të funksionojë. Në këmbim të kësaj, kooperativa ofron lehtësim në profile të ndryshme të biznesit në mënyrë që të zhvillojë bashkëpunimin, klientët, mundësitë si dhe ofron bashkëzhvillim profesional ndërmjet kolegëve.</p> <p>3. Stabiliteti dhe përmirësimi Kjo fazë i dedikohet konsultimit dhe këshillimit të sipërmarrësve nga kooperativa në ngritjen e bizneseve të tyre në një mënyrë të qëndrueshme.</p>
Burimet e disponueshme:	https://co-actions.coop/co-actions/la-cooperative/ http://www.europeannetforinclusion.org/call-good-practices-2020-1

Lloji i aktivitetit	Formim profesional
Shkolla Profesionale - ÖJAB (Österreichische Jung Arbeiter Bewegung/ Lëvizja e Punonjësve të Rinj Austriakë)	
Emërtimi: nëngrup/NEET, OSHC etj.	Të rinjtë e moshës ndërmjet 15 dhe 21 vjeç që kanë përfunduar arsimin e detyrueshëm
Objektivat e aktivitetit	Përgatitja dhe aftësimi i të rinjve për tregun e punës. Ofrimi i mbështetjes në kërkimin e një pune/profesionit ose trajnimit të mëtejshëm; Kuptimi i konceptit të të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe eksplorimi i alternativave të ndryshme;
Përshkrimi hap pas hapi	<p>Shkolla Profesionale është projektuar për të ofruar mbështetje për të rinjtë që nuk kanë mundësi të jenë pjesë e arsimit universitar si edhe nuk kanë kualifikimet e duhura për të aksesuar tregun e punës ose formimin profesional.</p> <p>Programi i shkollës ofron:</p> <p>1. Module trajnimi – Të gjitha modulet vendosen në dispozicion të studentëve dhe ata mund të trajnohen në një sërë fushash: hotelieri dhe gastronomi, punime artizanale, administrim zyre etj.</p> <p>2. Trajnim – Çdo pjesëmarrësi i caktohet një trajner i cili monitoron progresin e tyre dhe shërben si mbikëqyrës në kurs. Mbështetja e trajnerit varet nga nevojat dhe kërkesat e pjesëmarrësit dhe mund të përfshijë intervista për punë dhe periudhë “provë” të punës në disa sipërmarrje.</p> <p>3. Workshope - janë opsionale dhe shërbejnë për të përmirësuar aftësitë e pjesëmarrësve (digjitale dhe kulturore) si dhe ofrojnë disa aktivitete të kohës së lirë për të mbështetur mirëqenien e tyre.</p>
Rezultatet	Mesatarisht janë 34 të rinj që marrin pjesë në programin e shkollës profesionale.
Burimet e disponueshme:	https://ec.europa.eu/esf/www.oejab.at/produktionsschule https://www.facebook.com/oejab.at

Lloji i aktivitetit	Sipërmarrja sociale
---------------------	---------------------

SoFIT - Sipërmarrja sociale Graefewirtschaft Berlin, Gjermani

Emërtimi: nëngrup/NEET, OSHC etj.	Të rinjtë e shtresës në nevojë, kryesisht migrantë, pa shkollë apo kualifikime profesionale, të moshës 18 deri 35 vjeç
Objektivat e aktivitetit	Përmirësimi i jetës së të rinjve të shtresave në nevojë; Ofrimi i mundësive të punësimit për të rinjtë migrantë dhe refugjatë; Mbështetja për marrjen e kualifikimeve në industrinë e hotelerisë.
Përshkrimi hap pas hapi	Graefewirtschaft është një sipërmarrje sociale e themeluar nga migrantë të papunë. Sipërmarrja sociale ofron ushqime të freskëta dhe të shëndetshme për 13 shkolla, çerdhe dhe kopshte në Berlin. Ajo ka gjashtë kuzhina, duke përfshirë një mensë. Qëllimi i SoFIT është të integrojë migrantët në nevojë në fuqinë punëtore dhe t'u ofrojë atyre trajnime në mënyrë që t'i japë mundësinë për të qenë të pavarur financiarisht. Projekti SoFIT ofron: - Planifikim karriere; - Formim profesional dhe mbështetje drejt kualifikimeve;
Rezultatet	Pas programit të mbështetjes, pothuajse gjysma e të rinjve migrantë dhe refugjatë me anë projekti SoFIT të punësohen ose të marrin trajnime mëtejshme profesionale, ose nga organizata Graefewirtschaft ose me një nga organizatat e saj partnere në Berlin.
Burimet e disponueshme:	https://graefewirtschaft.org/

Lloji i aktivitetit	Program ndërhyrjeje përmes sporteve
Programi SPIN – SPIN Estoni	
Emërtimi: nëngrup/NEET, OSHC etj.	Të rinjtë me më pak mundësi, të rinjtë në rrezik (10-18)
Objektivat e aktivitetit	Qëllimi i programit është të reduktojë sjelljen e rrezikshme dhe të lehtësojë zhvillimin e aftësive sociale përmes sporteve.
Përshkrimi hap pas hapi	<p>Programi SPIN synon të rinjtë estoneze dhe ruse që të mësojnë aftësi të vlefshme sociale duke u përfshirë në aktivitete futbolli. Programi sportiv i të rinjve Kickz në UB shërben si një model për SPIN.</p> <p>Pjesëmarrësve të programit u kërkohet të marrin pjesë në tre seanca në baza javore. Dy seanca janë të përqendruara në futboll dhe seanca e tretë i kushtohet zhvillimit të aftësive të tjera sociale.</p> <p>Secili grup SPIN ka një trajner profesionist futbolli dhe një ndihmës trajner me përvojë në punën sociale ose me të rinjtë.</p> <p>Zhvillimi i fëmijëve vlerësohet duke matur shkallën e tyre të pjesëmarrjes dhe disiplinës në aktivitete të mbikëqyrura nga trajnerët, si dhe nga notat dhe sjellja e tyre në shkollë.</p>
Rezultatet	<p>Studimi i ndikimit të sezoneve 2015 deri 2017 tregoi që SPIN ka një ndikim të rëndësishëm në qëndrimet pro-sociale të së rinjve që morën pjesë në mënyrë aktive në program, duke i ndihmuar ata të përmirësojnë aftësitë e vetëkontrollit, të ndërtojnë vullnetin për të ndërmarrë rreziqe të arsyeshme dhe të frenojnë përgjigjet impulsive, duke përmirësuar sjelljen e tyre në shkollë, si dhe arritjet akademike.[2]</p> <p>Disa nga rezultatet tregojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> 8% përmirësim në rezultatet e shkollës 6% përmirësim i sjelljes në shkollë 19% përmirësim në aktivitete, pjesëmarrje dhe disiplinë 18% ulje e gatishmërisë për t'u përfshirë në sjellje të rrezikshme 12% përmirësim i vetëkontrollit 95% e pjesëmarrësve e vlerësojnë programin si të mirë ose të shkëlqyer
Burimet e disponueshme:	https://www.spinprogramm.ee/

[2] <https://www.britishcouncil.ee/en/programmes/society/spin-programme> Vlerësuar më: 25 shkurt 2020

Lloji i aktivitetit	Këshillim për karrierën dhe formim profesional
Qendra Sociale Murialdo	
Emërtimi: nëngrup/NEET, OSHC etj.	Grupet vulnerabël dhe komuniteti rom, veçanërisht gratë dhe të rinjtë në gjendje të pafavorizuar
Objektivat e aktivitetit	Mbështetja e të rinjve në vështirësi për shkak të gjendjes së tyre sociale, burra dhe gra që kanë nevojë për udhëzime dhe trajnime në mënyrë që të integrohen në tregun e punës dhe jetën sociale.
Përshkrimi hap pas hapi	<p>Qendra Sociale Murialdo operon në qytetin e Fierit (Shqipëri). Shërbimet e tyre janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> Kurset e formimit profesional - kurset kryesore përfshijnë: mekanik, ndihmës zyre, punëtorë hidraulik, saldator, projektues grafik dhe elektrikistë. Praktikë profesionale - pas përfundimit të kurseve, të gjithë pjesëmarrësve u ofrohet më pas një mundësi praktike në Fier. Bashkëpunimi me bizneset dhe institucionet arsimore lokale - QSM ka një shtrirje të gjerë në tregun e punës dhe u ofron punëdhënësve lokalë mundësi për të marrë pjesë në programet e praktikës. Ata tashmë kanë marrëveshje me biznese të ndryshme në qytetin e Fierit - biznese të prodhimit të tekstit, kompani ndërtimi, ofiçina, biznese private të fushave të tjera - grafikë, impiante elektrike dhe panele diellore. Nga ana tjetër, kanë marrëveshje me Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Fier, Shërbimin e Provës dhe Zyrën e Punës në Fier në mënyrë që të shtrijnë shërbimet për të rinjtë e tjerë që nuk bëjnë pjesë në grupmoshën 15-29 vjeç.
Rezultatet	Në vitin 2020, 4 të rinj përfunduan programet e tyre të praktikës dhe kanë siguruar kontrata pune.
Burimet e disponueshme:	https://www.facebook.com/Qendra-Sociale-Murialdo-336990703059572

Lloji i aktivitetit	Sipërmarrje sociale
Fuqizimi i Qendrës Xhonatan përmes biznesit social - Kafe “Te Xhoni”	
Emërtimi: nëngrup/NEET, OSHC etj.	Fëmijë dhe të rinj me Sindromën Down dhe ç'rregullime të spektrit të autizmit
Objektivat e aktivitetit	Platformë për mbështetje dhe përfshirjen e të rinjve me Sindromën Down në tregun e punës për t'i ndihmuar ata të arrijnë pavarësinë.
Përshkrimi hap pas hapi	<p>Misioni i Qendrës Xhonatan është të mbështesë fëmijët dhe të rinjtë me Sindromën Down dhe ç'rregullime të spektrit të autizmit. Të gjitha shërbimet që ofrohen brenda Qendrës janë falas për komunitetin vulnerabël. Qëndrueshmëria financiare duke qenë sfida më e madhe ka bërë që ata të krijojnë shërbime novatore në mënyrë që të gjenerojnë fonde shtesë për Qendrën. Fillimisht, ata filluan me prodhimin e kornizave, kartolinave dhe dekorimeve të tjera të cilat përgatiten nga përfituesit e shërbimeve të Qendrës përgjatë orëve të tyre të terapisë.</p> <p>Nisma e dytë ishte hapja e sipërmarrjes sociale, Kafe “te Xhoni” si një platformë për mbështetjen dhe përfshirjen e të rinjve me Sindromën Down në shoqëri dhe në tregun e punës. Kafeneja ka tre punonjës me kohë të plotë, njëri prej të cilëve është një i ri me Sindromën Down. Kjo sipërmarrje sociale i shërben në mënyrë të drejtpërdrejtë komunitetit të Sindromës Down (fëmijë dhe të rinj) dhe familjeve të tyre. Përveç kësaj, kafeneja shërben si një platformë për të rritur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e përfshirjes sociale përmes organizimit të eventeve të ndryshme sociale për publikun (“Dita e Bamirësisë”, “Dita e Grave”, “Dita Botërore e Sindromës Down”, “Netë Karaoke” etj).</p>
Rezultatet	<p>Aksesi i barabartë në tregun e punës për individët me sindromën Down si dhe pavarësi financiare.</p> <p>Zgjerimi i shërbimeve mbështetëse për përfituesit e Qendrës përmes të ardhurave (rritje e numrit të përfituesve që marrin terapi (nga 53 përfitues në vitin 2018 në 64 në vitin 2019), duke përfituar nga terapistë falas dhe kurset për aftësim për jetën duke kontribuar gjithashtu në jetesën e pavarur të 17 të rinjve).</p>
Burimet e disponueshme:	<p>http://www.downsyndromealbania.com/ https://partnersalbania.org/publication/social-enterprises-and-their-ecosystems-in-europe-country-fiche-albania/</p>

Lloji i aktivitetit	Zhvillimi i Tregut të Punës
RisiAlbania-Partner për Zhvillim - Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe zbatuar nga Helvetas dhe Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim	
Emërtimi: nëngrup/NEET, OSHC etj.	Të rinj të papunë të grupmoshës 15-29 vjeç
Objektivat e aktivitetit	<p>Qëllimi i kësaj iniciative ishte që mjetet e komunikimit masiv të bëhen ofrues të vazhdueshëm të informacionit mbi çështjet e punësimit. Ndërhyrja e medias synonte:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ndryshimi i nivelit të angazhimit të medias - Ndryshimi i mënyrës me anë të së cilës media në Shqipëri raporton dhe mbulon çështje që lidhen me punësimin / orientimin në karrierë; - Ndryshimin e sjelljes së audiencës - Ndryshimi i perceptimit dhe sjelljes së audiencës mbi tregun e punës, në veçanti të të rinjve dhe prindërve të tyre; - Ndryshimin e nivelit të punësimit - Ndikimi në punësim duke orientuar vajzat dhe djemtë e rinj për të gjetur punën e duhur që nuk do ta kishin gjetur ndryshe.
Përshkrimi hap pas hapi	<ul style="list-style-type: none"> - Analizë e sektorit të medias dhe përmbajtjes mediatike; - Mbledhje e praktikave më të mira ndërkombëtare/rajonale të informacionit cilësor për tregun e punës; - Seminare mbi raportimin e punësimit; - Mbështetje financiare për produkte novatore mediatike në lidhje me punësimin e të rinjve; - Pilotimi dhe testimi i produkteve të përzgjedhura mediatike; - Ndërtimi i kapaciteteve të medias për raportimin cilësor të punësimit tek të rinjtë; - Zhvillimi i një moduli edukimi mbi politikën dhe raportimin e tregut të punës.
Rezultatet	<p>Në total, u transmetuan 6 produkte mediatike të mbështetura drejtpërdrejt nga RisiAlbania gjatë kohëzgjatjes së projektit. Produktet mediatike varionin nga ato mbi tregun e punësimit, sipërmarrësen dhe vetëpunësimin. Ky portofol synonte jo vetëm të rinjtë, por edhe informimin e prindërve të tyre.</p> <p>Ndryshimi i nivelit të angazhimit të medias – kjo iniciative tregoi shenja qëndrueshmërie të produktit dhe tregut.</p> <p>Ndryshimi i sjelljes së audiencës - si rezultat i dëgjimit, shikimit ose leximit të produkteve mediatike, studimi tregoi se gati 87% i shihnin si të dobishme ose shumë të dobishme këtë ndërhyrje. 71% besojnë se kanë ndryshuar perceptimin për vendet e punës dhe karrierën dhe pothuajse një e treta deklaroi se kjo kishte sjellë ndryshimin e sjelljes në kërkimin e punësimit, me një ndikim të përgjithshëm pothuajse të barabartë midis grave dhe burrave. Ndryshimet e sjelljes së audiencës konsistuan në ndërmarrjen e trajnimeve për t'ë zgjeruar mundësi të reja punësimi ose për të krijuar biznese ose për të konsideruar punë në sektorë të cilët nuk do t'i kishin marrë parasysh më parë.</p> <p>Ndryshimi i nivelit të punësimit - studimi tregon se 71% e audiencës është ndikuar nga produktet mediatike. 39% e audiencës ka ndryshuar të mbi problemet e punësimit dhe 32% ndryshuan perceptimin dhe sjelljen e tyre si rezultat i dëgjimit, shikimit ose leximit të mediave të fokusuara tek punësimi.</p>

Burimet e
disponueshme:

<https://www.risialbania.al/?lang=en>
<https://www.facebook.com/risial>

Lloji i aktivitetit	Sipërmarrje sociale
SHËRBIME PASTRIMI YAPS	
Emërtimi: nëngrup/NEET, OSHC etj.	Të rinjtë e moshës 15-29 vjeç që vijnë nga komunitete të marginalizuara dhe zona rurale - jetimë, të komunitetit rom, egjiptian, njerëz me gjendje të vështirë financiare
Objektivat e aktivitetit	Ofrimi i programeve të trajnimit dhe arsimit për të rinjtë nga komunitetet e marginalizuara; Krijimi i mundësive të punësimit dhe mundësimi i hyrjes në tregun e punës.
Përshkrimi hap pas hapi	<p>YAPS është biznesi i parë social në Tiranë. YAPS punon në fushat – shërbim postar, pastrim dhe shërbime riparimi. 90% e korrierëve të YAPS janë të rinj nën moshën 29 vjeç.</p> <p>Në fillim YAPS filloi me 600 shërbime në muaj dhe tani YAPS ka arritur përafërsisht 100,000 shërbime në muaj të cilat përfshijnë shërbimin e pastrimit në shtëpi, zyra, qendra biznesi etj .; larje e kolltuqeve, divaneve; shkëlqimin e objekteve të veçanta dhe të parketeve; pastrimi dhe larja e tapeteve, kolltuqeve, karrigeve; dezinfektimi i mikrobeve nga mjedise të ndryshme; pastrimi i ndërtesave të reja dhe shumë më tepër. Përveç kësaj, YAPS ofron shërbim postar dhe ka disa lloje shërbimesh që zbatohen në të gjithë territorin shqiptar dhe më gjerë.</p> <p>YAPS bashkëpunon me institucionet publike siç janë Zyrat e Punës dhe Shërbimi i Provës me qëllim marrjen e informacionit për të rinjtë NEET dhe përfshijen e tyre.</p>
Rezultatet	Në 3 vitet e fundit, ka pasur më shumë se 250 të rinj që janë të punësuar në YAPS dhe pjesa më e madhe e tyre janë brenda grupmoshës 15-29. Aktualisht YAPS ka të punësuar 112 të rinj dhe të gjithë janë jetimë, të komunitetit rom, të komunitetit egjiptian ose njerëz që vijnë nga një gjendje e vështirë financiare.
Burimet e disponueshme:	http://www.yaps.al/yaps/?lang=en

Lloji i aktivitetit	Program mbështetës për sipërmarrjet sociale
EMBRACE - Modele Sipërmarrjeje që ndërtojnë Marrëdhënie dhe Ekonomi Krijuese - Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim	
Emërtimi: nëngrup/NEET, OSHC etj.	OSHC-të dhe sipërmarrjet sociale në Shqipëri
Objektivat e aktivitetit	Kontribut në zhvillimin e ekonomisë sociale duke nxitur zhvillimin gjithëpërfshirës në vend përmes krijimit të modeleve të suksesshme të sipërmarrjeve sociale të qëndrueshme në Shqipëri.
Përshkrimi hap pas hapi	<ul style="list-style-type: none"> - Programi i ndërtimit të kapaciteteve për OSHC-të për të filluar/forcuar iniciativat e tyre në fushën e sipërmarrjes sociale; - Mbështetje financiare për sipërmarrjet sociale për të vazhduar ose përmirësuar biznesin e tyre dhe për të kontribuar në punësimin dhe përfshirjen sociale të grupeve të pafavorizuara; - Ekspozimi ndaj rrjeteve ndërkombëtare, mundësi rrjetëzimi dhe mundësi të zhvillimit të biznesit – SS-të shqiptare njihen me mundësitë për rrjetëzim dhe bashkëpunim në rrjete të ndryshme rajonale.
Rezultatet	<p>45 OSHC zhvilluan aftësitë për të filluar/përmirësuar iniciativat e tyre të sipërmarrjeve sociale, nga të cilat 15 ishin organizata rinore të përqendruara në punësimin dhe fuqizimin e të rinjve.</p> <p>15 sipërmarrje sociale u mbështetën për të drejtuar sipërmarrje efikase dhe për të kontribuar në punësimin dhe përfshirjen sociale të grupeve të pafavorizuara.</p> <p>Rreth 46 persona janë punësuar me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme dhe janë integruar mbi 100 persona (gra të reja të papuna, gra në konflikt me ligjin, të rinj të papunë, të rinj me sindromën Down, të rinj nga komuniteti rom, etj.)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përfitues të drejtpërdrejtë të sipërmarrjeve sociale janë rreth 1494 persona, ku 17 të rinj janë trajnuar si guida turistike; - 302 fëmijë/të rinj u edukuan për sporte dhe ushqim të shëndetshëm; - 20 gra/disa prej tyre gra të reja në konflikt me ligjin u trajnuan për punë artizanale; - 150 gra përfituan shërbime falas; - 92 gra që jetojnë në zona rurale janë trajnuar; - 200 nëna u edukuan për ushqim të shëndetshëm; - 40 artizanë u ndihmuan në shitjen e produkteve të tyre; - 17 të rinj me sindromën Down u trajnuan në kurse pavarësie; - 5 gra nga familje të varfra përfituan nga shërbimet para lindjes/pas lindjes; - 110 të rinj u përfshinë në aktivizëm; - 25 jetimë dhe 8 të moshuar janë përfshirë në aktivitete argëtuese dhe kanë përfituar ushqim falas.
Burimet e disponueshme:	https://partnersalbania.org/embrace-entrepreneurship-models-building-relations-and-creative-economy/

Lloji i aktivitetit	Sipërmarrje sociale
Pana Storytelling Furniture	
Emërtimi: nëngrup/NEET, OSHC etj.	Të rinjtë në rrezik: jetimë, emigrantë të kthyer, të rinj të komunitetit rom dhe egjiptian
Objektivat e aktivitetit	Pana është një sipërmarrje sociale dhe ekologjike që prodhon mobilje të bëra me porosi përmes ripërdorimit të mbetjeve drusore që gjenden tashmë në treg dhe punëson individë nga grupe të marginalizuara.
Përshkrimi hap pas hapi	<p>“Pana Story Telling Furniture” është një sipërmarrje e cila vjen si rezultat i mbështetjes së drejtpërdrejtë nga një konkurs për nisma të sipërmarrjes sociale dhe ideve të gjelbra.</p> <p>Qëllimi i tregut të “Pana” është të dizenojë mobilje dhe ambiente të brendshme. Megjithatë, ndryshimi kryesor dhe vlera e shtuar është se kjo është një sipërmarrje e përqendruar tek mjedisi, sepse prodhimi nënkupton përdorimin e mbetjeve drusore nga shtëpitë e shkatërruara, paletat dhe burime të tjera, dhe misioni i saj social është të punësojë dhe t'u ofrojë mundësi njerëzve në nevojë - jetimë, migrantë të kthyer, punëtorë të moshuar.</p>
Rezultatet	Në këtë moment, “Pana Storytelling Furniture” ka të punësuar 18 punonjës me kohë të plotë, nga të cilët 12 janë jetimë, të rinj të papunë, emigrantë të kthyer, persona me aftësi të kufizuara mendore ose të komuniteteve rom dhe egjiptiane.
Burimet e disponueshme:	https://www.facebook.com/panaalbania



TURQIA

Lloji i aktivitetit	Program për zhvillimin e aftësive
Shoqata “Yeni Bir Lider” - Programi i Bursave LEAD21	
Emërtimi: nëngrup/NEET, OSHC etj.	Të rinj të grup-moshës 18-25 vjeç
Objektivat e aktivitetit	Përmirësimi i aftësive drejtuese të studentëve në universitete
Përshkrimi hap pas hapi	<p>Programi i Bursave LEAD21 është një program një vjeçar që përgatit 21 studentë me potencial për aftësi drejtuese. Aplikantët janë studentë të universiteteve dhe i takojnë grup moshës deri në 25 vjeç. Pjesëmarrësit e zgjedhur marrin një pagë mujore gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit.</p> <p>Programi ka 5 faza:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kampi i lidërsipit - Në fazën e parë, përfaqësuesit e LEAD21 marrin pjesë në një kamp lidërsipi 4-ditor. Në këtë kamp, mbahen seanca stimulimi me akademikë dhe drejtues biznesi në kuadrin e vizionit të lidërsipit të shekullit 21. 2. Samiti LEAD21 - Kjo fazë përbëhet nga seanca aktivitetesh online dhe onsite që synojnë ti shtojnë vlerë “Udhëtimit të Lidërsipit” të të rinjve. Në këto seanca, zhvillohen diskutime dhe tryeza të rrumbullakëta në kuadrin e vizionit me profesionistë të biznesit. Aktivitetet e rrjetit variojnë nga takimet me profesionistë të ndryshëm deri te studimet e rasteve me pjesëmarrjen e drejtuesve të institucioneve publike. 3. Kampi “Gjallërohu” – Kampi shërben si një pikë kontrolli për pjesëmarrësit e “Udhëtimit të Lidërsipit” dhe gjithashtu për të kontaktuar me të rinjtë e tjerë dhe për t’i angazhuar ata në diskutime rreth lidërsipit. 4. Faza trajnimit online mbi Lidërsipin - të rinjtë kanë akses në një trajnim online mbi lidërsipin dhe partneri ekzekutiv i kësaj faze është Akademia Turkcell. 5. Rrjetëzimi - në fazën e pestë, të rinjtë marrin pjesë në programe mujore që përbëhen nga aktivitete të botës së biznesit, takime kulturore-artistike dhe aktivitete të tjera rrjetëzimi. <p>Aktivitetet e mbajtura në kuadër të programit janë pjesë e trajnimit, konsultimit dhe këshillimit 6-mujor që kontribuon në zhvillimin e projekteve për përgjegjësinë sociale. Të rinjtë marrin konsulta individuale nga përfaqësues të botës së biznesit dhe themelues të bizneseve të suksesshme. Të rinjtë pjesëmarrës zhvillojnë projekte mbi përgjegjësinë sociale dhe do të drejtojnë këto projekte për 6 muaj në përputhje me objektivat e “Udhëtimit të Lidërsipit Social” dhe Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara. Pas përfundimit me sukses të programit, pjesëmarrësit bëhen pjesë e komunitetit “Alumni” dhe vazhdojnë të përfitojnë nga mbështetje të ndryshme dhe ekosistemi.</p>

Rezultatet	Gjatë vitit 2019-2020 janë organizuar 9 praktika punësimi. Janë ndërmarrë 7 iniciativa në komunitetet lokale dhe është siguruar një punësim me kohë të plotë për të rinjtë pjesëmarrës.
Burimet e disponueshme:	https://yenibirlider.org/lead21/

Lloji i aktivitetit	Praktika profesionale dhe përvojat e para të punës
---------------------	----------------------------------------------------

Ëilk Firsat (Mundësia e Parë) - Esas Sosyal (Esas Social)

Emërtimi: nëngrup/NEET, OSHC etj.	Të rinjtë e sapo-diplomuar nga universitetet që hyjnë në tregun e punës
Objektivat e aktivitetit	Ofrimi i mundësive të barabarta për të rinjtë e sapo-diplomuar për kalimin në tregun e punës (punën e tyre të parë); Ofrimi i mbështetjes për vajzat dhe gratë në mënyrë që ato të zhvillojnë më tej aftësitë dhe rrjetet e tyre të komunikimit, duke mundësuar kështu një start të mirë karriere për to.
Përshkrimi hap pas hapi	Programi është hartuar për t'u ofruar të rinjve të sapo-diplomuar aftësitë dhe përvojën e nevojshme të punësimit. Shtyllat e programit janë: - Program pune një vjeçar në OJQ-të e përzgjedhura - Akademia "Mundësia e Parë" - e cila u ofron të rinjve mundësinë për të zhvilluar aftësitë e tyre përmes trajnimeve, monitorimeve dhe aktiviteteve të tjera në drejtim të punësimit.
Rezultatet	- 95 pjesëmarrësve të akademisë "Mundësia e Parë" iu ofruan praktika pune në 22 organizata joqeveritare. - Shkalla e rekrutimit të të rinjve që përfunduan programin në 3 muajt e parë ishte 94%. - 60% e 95 pjesëmarrësve filluan të punojnë në kompani prestigjioze të sektorit privat dhe 40% në organizata joqeveritare. - U realizuan disa aktivitete informimi për sektorin privat në lidhje me të rinjtë që ishin pjesë e akademisë "Mundësia e Parë" - CV-të e pjesëmarrësve u janë dërguar më shumë se 120 institucioneve të cilët ishin mbështetës të programit në vitin 2020. - Në këto institucione u kryen intervista gjatë gjithë vitit. Informacion i detajuar iu dha rreth 40 institucioneve, duke marrë parasysh aplikimet për punë sipas pozicioneve të lira.
Burimet e disponueshme:	http://www.ilkfirsat.org/en

Lloji i aktivitetit	Praktika profesionale dhe përvojat e para të punës
---------------------	----------------------------------------------------

Benim Geleçim Gençlik Merkezi Projesi - Projekti i Qendrës Rinore “E ardhmja ime”

Emërtimi: nëngrup/NEET, OSHC etj.	Të rinj të grup-moshës 18-25 vjeç (50% gra dhe burra, 20% turq dhe 80% sirianë)
Objektivat e aktivitetit	<ul style="list-style-type: none"> - Kryerja e këshillimit familjar dhe aktiviteteve mbështetëse në familje në mënyrë që të parandalohet puna e fëmijëve duke nxitur punësimin e të rinjve; - Mbështetja e të rinjve për të marrë pjesë në trajnime mbi punësimin dhe në trajnime të dedikuara për të fituar aftësi në kërkimin, gjetjen e një pune dhe në mbajtjen aktive të bizneseve të tyre; - Ofrimi i mbështetjes për të orientuar të rinjtë drejt zyrave të regjistrimit të punës përmes praktikës 3-mujore të paguar; - Mbështetja e të rinjve nëpërmjet ofrimit të trajnimeve bazë mbi sipërmarrjen; - Asistencë për të rinjtë që duan të fillojnë biznesin e tyre duke i mbështetur iniciativat e tyre me një financimin fillestar.
Përshkrimi hap pas hapi	<ul style="list-style-type: none"> - Trajnime bazë mbi sipërmarrjen; - Informim mbi përvojat e punësimit që lidhen me këshillimet familjare. Praktika 3-mujore të mbështetura nga stimuluesit; - Ofrimi i fondeve për mbështetje të sipërmarrjes për ato grupe që kanë nevojë për mbështetje ekonomike; - Mbështetja e përfshirjes së grupeve të emigrantëve në institucionet lokale (IŞKUR, portalet e dedikuara për kërkim pune pranë bashkive, agjencitë private të punësimit dhe platformat online të zhvillimit të karrierës). - Informacione mbi karrierën dhe kurse për hartimin e CV-ve; - Fitimi i përvojave të punësimit për një cikël të qëndrueshëm biznesi (Intervista zyrtare, marrja e lejes së punës, regjistrimet në ISSH, nënshkrimi i kontratave të punës) - Marrja e njohurive bazë në lidhje me ligjin e punës në Turqi dhe legjislacionin e punës në tërësi; - Mbështetja e kontaktit të vazhdueshëm të grupit Sirian të emigrantëve me autoritetet lokale (pjesëmarrja e tyre në aktivitete të bashkisë si anëtarë të stafit duke mundësuar përfshirjen e grupeve të emigrantëve si pjesë e autoriteteve bashkiake, ku ata bëjnë prezantime të planeve të biznesit lidhur me sipërmarrjen); - Ofrimi i kurseve profesionale dhe gjuhësore si dhe certifikimi për kurset në fjalë; - Ofrimi i mbështetjes dhe i aksesit në vendin e punës për të rinjtë refugjatë me aftësi të kufizuara;

Rezultatet	<ul style="list-style-type: none">- Mesatarisht 300 të rinj morën pjesë në trajnimet e punësimit dhe në trajnimet e dedikuara për kërkimin e punës.- Mesatarisht 300 të rinj zhvilluan aftësitë e tyre për hapjen e një biznesi.- Të rinjve që kanë punuar që në fëmijëri iu mundësua akses në punë me kushte të sigurta dhe formale.- Të rinjtë që janë mbështetur për të zhvilluar aftësitë në kërkimin e një pune janë bërë pjesë e një kategorie pune (të regjistruar).- Gratë që kanë nevojë për mbështetje ekonomike, të cilat vazhdojnë arsimin e tyre universitar ose që janë kategoria që ka nevojë për kujdes të veçantë brenda familjes, të reja që nuk mund të punojnë me kohë të plotë për arsye të ndryshme i kanë kthyer prodhimet shtëpiake ose idetë e sipërmarrjes në aktivitete fitimprurëse.
Burimet e disponueshme:	http://mudem.org/

Lloji i aktivitetit	Këshillim dhe udhëzim për karrierën
---------------------	-------------------------------------

Zyra e Karrierës dhe Zhvillimit të Biznesit në Çanakkale

Emërtimi: nëngrup/NEET, OSHC etj.	Të rinjtë e grup-moshës 15-29 vjeç, të rinjtë e papunë që janë në proces të përzgjedhjes së një pune dhe një profesioni
Objektivat e aktivitetit	Planifikimi i punësimit dhe karrierës për të rinjtë e papunë, për personat që hyjnë për herë të parë në tregun e punës; Programet e trajnimit të aftësive dhe trajnimit profesional; Informacione dhe udhëzime për karrierën; Mbështetje për kërkim pune;
Përshkrimi hap pas hapi	<p>Përmbajtja e këtyre kurseve përzgjidhet në përputhje me nevojat dhe profesionet më të kërkuara në tregun e punës. Këto të dhëna merren nga raporti i analizës së tregut të punës të Drejtorisë Lokale të Agjencisë së Punësimit në Çanakkale.</p> <p>Kurset e ofruara janë si në vijim:</p> <p>Kurse profesionale:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Trajnim mbi sipërmarrjen e zbatuar - KOSGEB; - Trajnim mbi shitjet dhe marketingun; - Trajnimi stafi për pastrimin e dyshemesë; - Trajnim mbi qeramikën dhe dizajnin e dhuratave; bronz/argjend - Trajnim për roje plazhi dhe trajnim për ndihmën e parë/shpejtë; - Trajnim për shkrim projektsh lidhur me kreditë dhe grantet bujqësore. <p>Trajnime të certifikuara nga Ministria e Arsimit Kombëtar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kurs për mirëmbajtjen dhe riparimin e sistemit kompjuterik; - Kurs për krijimin e faqeve të internetit; - Kursi në grafikë dhe animacion; - Programim i orientuar - Trajnim për zhvillimin dhe përshtatjen në programin "Java"; - Programim dinamik i internetit - trajnim për zhvillimin dhe përputhshmërinë e të dhënave; - Trajnim për zhvillimin dhe përshtatjen e programimit në celularët me sistem Android. - Seminare për zhvillimin personal; - Trajnime mbi vullnetarizmin dhe shoqërinë civile, drejtimin e punës në ekip dhe menaxhimin e kohës; - Trajnim mbi përgatitjen/shkrimin e Projekteve; - Trajnim mbi të drejtat e njeriut dhe demokracinë; - Trajnim mbi mënyrën e të folurit dhe oratorinë; - Trajnim mbi hartimin e CV-ve dhe mbi menaxhimin e intervistave të punës.

Rezultatet	<ul style="list-style-type: none">- Kurse profesionale të certifikuara për 210 të rinj;- Seminare mbi zhvillimin personal për 320 të rinj;- Seanca informuese mbi karrierën për nxënësit e 15 shkollave të mesme në Çanakkale.- Në total, 725 të rinj ndoqën kurset e trajnimit profesional, kurset e certifikuara kompjuterike dhe seminarët e zhvillimit personal.
Burimet e disponueshme:	https://www.kozagenclikdernegi.org/kariyer-is-gelistirme-ofisi/

Lloji i aktivitetit	Masa të marra për një treg pune aktiv
---------------------	---------------------------------------

EKIP - Platforma efektive e punësimit të grave - Carma/Jana

Emërtimi: nëngrup/NEET, OSHC etj.	Të rinj Turq dhe gra të reja Siriane të cilët janë në mbrojtje të përkohshme, jetojnë në Stamboll dhe janë mbi moshën 18 vjeç.
Objektivat e aktivitetit	<p>Krijimi i modeleve të qëndrueshme të punësimit duke bërë bashkë gratë e reja siriane dhe të rinjtë turq përmes modelit të kooperativës. Modeli i kooperativës u jep të dy palëve drejtën për të mbajtur asamblenë e përgjithshme dhe pjesëmarrje në nivel të barabartë. Qëllimi kryesor i kooperativës është të përgatisë produkte të shëndetshme, të besueshme, novatore dhe sezonale.</p> <p>Fuqizimi i grave përmes trajnimeve, vizitave, këshillimit dhe aktiviteteve të ndryshme paralelisht me krijimin e një modeli të qëndrueshëm financiar.</p> <p>Ofrimi i një përvoje të vërtetë pune për gratë pjesëmarrëse në projekt për tu mundësuar atyre përmirësimin e njohurive digjitale, njohurive mbi menaxhimin dhe mbi vendimmarrjen.</p>
Përshkrimi hap pas hapi	<p>Aktivitetet e projektit ndahen në dy grupe kryesore.</p> <p>1. Aktivitetet për Fuqizimin e Grave:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Programet e trajnimit për gratë (trajnim mbi menaxhimin financiar, trajnim mbi sipërmarrjen, trajnime që lidhen me mendësinë e të bërit biznes, trajnime mbi menaxhimin e projekteve, trajnime mbi marketingun dhe trajnime për barazinë gjinore. - Vizita dhe aktivitete (organizimi i mëngjeseve në grupe, takimeve, vizitave në ferma dhe fabrika, takime me aktorë të tjerë nga industria ushqimore, etj.) - Takime (takimet e grave së bashku me ekipin e projektit dhe me profesionistë të tjerë në formën e progresit dhe simulimit të asamblesë së përgjithshme në të cilën gratë takohen. <p>2. Aktivitetet e Modelit të Punësimit të Qëndrueshëm</p> <ul style="list-style-type: none"> - Studime mbi kooperativat - Studime që lidhen me marketingun (evidentimi i aktiviteteve promovuese në bashki dhe institucione, realizimi i studimeve të marketingut dhe prodhimi i elementëve të vizibilitetit) - Dizajni i produktit (Prodhimi i 16 sallatave, siguria ushqimore dhe vlerat ushqyese janë studiuar me kuzhinierë dhe dietologë)

Rezultatet	<ul style="list-style-type: none"> - Hapja dhe drejtimi i një kooperative ushqimore nga gratë pjesëmarrëse në programin e trajnimit. - Kooperativa ushqimore prodhon 16 lloje sallatash të shëndetshme – 4 lloje sallatash për çdo sezon dhe 3 të tjera me përbërës sezonalë. - 18 sirianë dhe 3 gra nga Turqia vazhdojnë trajnimet. 12 prej tyre janë partnerë zyrtarë të kooperativës. - Fuqizimi i grave përmes mundësitë të qëndrueshmërisë financiare për familjet e grave që bashkëpunojnë. - Shembulli i praktikës së mirë dhe modeli i punësimit u krijua kur u punësuan 12 gra që morën pjesë në program. - Përafërsisht 300 njerëz u fuqizuan sa i takon çështjes së punësimit. <p>Suksesi i projektit solli mbështetje shtesë dhe mbështetje në natyrë nga bashkia lokale. Komuna e Küçükçekmece (në Stamboll) ofroi një hapësirë lokale që të përdorej për një kohë të pacaktuar.</p>
Burimet e disponueshme:	<p>https://ekiplatformu.com/tr/hakkimizda/</p>

Lloji i aktivitetit	Trajnim mbi aftësitë e punësimit
GRATË DREJTUESE TË SË ARDHMES - KAGIDER Shoqata e Grave Sipërmarrëse të Turqisë	
Emërtimi: nëngrup/NEET, OSHC etj.	Gratë e grup-moshës 20-25 vjeç, të cilat flasin anglisht, mundësisht studente universiteti ose të sapo-diplomuara
Objektivat e aktivitetit	<ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja e vajzave të reja për jetën e biznesit; - Rritja e aftësive të grave dhe rrjeteve profesionale të komunikimit, për të siguruar nxitje në karrierën e tyre të hershme dhe jetën e biznesit.
Përshkrimi hap pas hapi	<ul style="list-style-type: none"> - Trajtime 4-ditore për zhvillimin personal, njohuri sektoriale, njohuri mbi dinamikën e ciklit të biznesit dhe për planifikimin e karrierës; - Ofrimi i këshillimit në procesin e kërkimit të punës nga të diplomuarit e mëparshëm dhe trajnerët në përputhje me nevojat e pjesëmarrësve.
Rezultatet	<ul style="list-style-type: none"> - Aftësi të përmirësuara për të rejat e diplomuara; - Këshillimi në distancë dhe mundësim aksesi në rrjetin e të sapo-diplomuarve; - Ofrimi i informacioneve të mëtejshme mbi karrierën dhe burimet në dispozicion.
Burimet e disponueshme:	https://www.kagider.org/en/young-kagider/projects/lists/genc-kagider-projeler/women-leaders-of-the-future-project

Lloji i aktivitetit	Program trajnimi
Akademia e Punës së të Rinjve - TOY Gençlik Derneği (Shoqata Rinore TOY)	
Emërtimi: nëngrup/NEET, OSHC etj.	Të rinjtë e grup-moshës 18-30 vjeç që dëshirojnë të angazhohen profesionalisht në sektorin e shoqërisë civile ose që janë të gatshëm për të qenë pjesë e fuqisë punëtore dhe kërkojnë pajisjen me aftësi shtesë
Objektivat e aktivitetit	Përmirësimi i kapaciteteve edukative, komunikuese, organizative dhe i kompetencave të së rinjve që duan të punojnë në sektorin e shoqërisë civile.
Përshkrimi hap pas hapi	<p>Akademia e Punës së të Rinjve është krijuar për t'iu përgjigjur nevojave në rritje për burime dhe kapacitete shtesë në shoqërinë civile të Turqisë. Programi i Akademisë është hartuar bazuar në vlerësimin e nevojave dhe nga të dhënat e organizatave rinore të cilat shfaqin interes në këtë drejtim.</p> <p>Akademia ka dy komponentë kryesorë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kampet e trajnimit për përmirësimin e njohurive dhe aftësive teorike dhe praktike. 2. Procesi i këshillimit - Të rinjtë pjesëmarrës morën këshillim individual nga profesionistë dhe punonjës të rinj të cilët trajtuan të gjitha çështjet e lidhura me projektin. Ky proces këshillimi ka mbështetur shkëmbimin e njohurive dhe komunikimin midis të rinjve. Të rinjtë kishin mundësinë të merrnin udhëzime lidhur me qëllimet dhe planet e tyre të karrierës nga mentorët e tyre si dhe të krijonin kontakte të reja.
Burimet e disponueshme:	https://www.toygenclik.org/

Lloji i aktivitetit	Trajnim mbi aftësitë e punësimit
INGEV- Përmirësimi i Aksesit në Mundësitë e Jetesës për Refugjatët me Aftësi të Kufizuara	
Emërtimi: nëngrup/NEET, OSHC etj.	Refugjatët në Turqi, me fokus të veçantë tek personat me aftësi të kufizuara dhe të rinjtë
Objektivat e aktivitetit	Ofrimi i mbështetjes për punësimin dhe vetëpunësimin e individëve me aftësi të kufizuara në Stamboll;
Përshkrimi hap pas hapi	<ul style="list-style-type: none"> - Intervista telefonike për përcaktimin e kapaciteteve të refugjatëve sirianë, veçanërisht personave me aftësi të kufizuara; - Përgatitja e planeve individuale të karrierës; - Zhvillimi i një platforme informacioni me një pikë të vetme kontakti, abledturkey.com, me qëllim që të ofrojë informacion dhe udhëzime lidhur me aftësinë e kufizuar, punësimin, shërbimet për refugjatët dhe sipërmarrjen me një sistem identifikimi; - Trajtime për karrierën për të hartuar një CV, përgatitje për intervista pune; - Trajtime profesionale për profesionin e shërbimit të klientit dhe aftësitë digjitale (p.sh. MS Office) - Shërbime këshillimi sipërmarrjeje për kandidatët e interesuar; - Skema asistence me anë të granteve për sipërmarrësit që mbështesin një formë të aftësisë së kufizuar ose mbështetje për bizneset që mundësojnë përfshirjen e sa më shumë personave me aftësi të kufizuara në forcën punëtore.
Rezultatet	<ul style="list-style-type: none"> - Janë identifikuar më shumë se 300 refugjatë (sirianë dhe individë me aftësi të kufizuara) të gatshëm për t'u bërë pjesë e forcës punëtore; - Është mundësuar ofrimi i këshillimit dhe mbështetjes së karrierës në krijimin e planeve individuale për 117 nga këta individë të cilët janë gatshëm të angazhohen në tregun e punës; - Rreth 150 individë morën pjesë në trajnimet për planifikimin e karrierës; - Është siguruar mbështetje dhe punësim për 14 pjesëmarrës në sektorin privat, dhe mbështetje në hapjen e bizneseve për 9 individë të tjerë. - Shërbimet e këshillimit janë ofruar në më shumë se 100 seanca - 5 kompani përfituan nga mbështetja me grante.
Burimet e disponueshme:	

Lloji i aktivitetit	Trajnim dhe praktikë profesionale
Programi i Trajnimit dhe Praktikës Paraprake për Përshtatjen e në Tregun e Punës në Turqi - Shoqata Mbështetje për Jetën	
Emërtimi: nëngrup/NEET, OSHC etj.	Të rinjtë e grup-moshës 18-24 vjeç, shtetas turq dhe sirianë që janë në mbrojtje të përkohshme
Objektivat e aktivitetit	<ul style="list-style-type: none"> - Përmirësimi i aftësive të punësimit së të rinjve të grup moshës 18-24; - Shkëmbim njohurish dhe përvojash midis të rinjve; - Akses në mundësitë e punësimit.
Përshkrimi hap pas hapi	<ul style="list-style-type: none"> - Ofrimi i trajnimeve të certifikuara për zhvillimin e aftësive; - Ndërtimi i kapaciteteve të punëdhënësve për integrimin e refugjatëve në punë; - Programi i praktikës profesionale.
Rezultatet	<p>Programi ka kontribuar në përmirësimin e aftësive të punësimit së të rinjve përfitues të këtij programi. Aktivitetet e ekspozimit dhe veprimit të përbashkët për përfituesit turq dhe sirianë mundësuan diskutime të hapura dhe rritje të ndërgjegjësimit lidhur me pengesat dhe paragjykimet me të cilat përballet secili nga grupet në tregun e punës. Punëdhënësit u ndërgjegjësuuan në termat e të kuptuarit më mirë të nevojave për integrim në punë dhe kërkesat e ligjit të punës për punësimin e refugjatëve.</p> <p>Përvoja e punës e fituar përmes programit të praktikës siguroi njohuri dhe aftësi shtesë për të rinjtë dhe mundësoi punë të reja dhe gjenerim të ardhurash, duke mbështetur në këtë mënyrë edhe familjet e përfituesve.</p>
Burimet e disponueshme:	

Lloji i aktivitetit	Trajnim i aftësive digjitale
Shoqata "Habitat" – Projektoni të Ardhmen Tuaj	
Emërtimi: nëngrup/NEET, OSHC etj.	Të rinjtë e grup-moshës 18-30 vjeç
Objektivat e aktivitetit	<ul style="list-style-type: none"> - Ofrimi mundësisë për përdoruesit e platformës www.geleceeginitasarla.com për të marrë pjesë në trajnimet për përmirësimin e aftësive të tyre digjitale, sociale si dhe në trajnimet e dedikuara kërkimit të një pune në mënyrë efikase; - Përmirësimi i aftësive sociale dhe digjitale të punëkërkuësve duke kontribuar në rritjen e niveleve të punësimit; - Mbështetja e vullnetarëve të rinj për të shpërndarë në mënyrë individuale njohuritë edukative me bashkëmoshatarët e tyre; - Mbështetja për zhvillimin e kapaciteteve të së rinjve së bashku me mësuesit/mentorët.
Përshkrimi hap pas hapi	<ul style="list-style-type: none"> - Trajtime mbi Aftësimin dhe Punësimin në Shekullin e 21-të, - Trajnim për krijimin dhe menaxhimin e përmbajtjes digjitale në Microsoft Word - Trajnim për mjedisin digjital të zyrës me anë të mjeteve Microsoft; - Trajtime për shkrim-lexim digjital (punë me kompjuter, qasje në informacionet në internet, komunikim në internet, pjesëmarrje e sigurt dhe e përgjegjshme në internet); - Trajtime efikase për përgatitjen e prezantimeve; - Trajtime për informacionet bazë në Microsoft Office dhe për përdorimin e të dhënave në Excel. - Ofrimi i aktiviteteve që lidhen me punësimin e të rinjve (së bashku me trajnimet e dhëna për mjedisin digjital).
Rezultatet	Rreth 30,000 individë/të rinj u përfshinë në program gjatë vitit 2019. Mbi 350,000 individë/të rinj morën pjesë në aktivitetet e mbajtura në kuadër të programit gjatë periudhës 2005-2010.
Burimet e disponueshme:	



MAQEDONIA E VERIUT

Lloji i aktivitetit	Zhvillimi i Tregut të Punës
---------------------	-----------------------------

Edukimi për Punësim në Maqedoninë e Veriut – Helvetas

Emërtimi: nëngrup/NEET, OSHC etj.	Të rinjtë e papunë në përgjithësi, me fokus specifik në grupe vulnerabël si komuniteti rom, personat me aftësi të kufizuara, njerëzit nga zonat rurale dhe gratë në disa kushte të caktuara
Objektivat e aktivitetit	Përmirësimi i cilësisë së arsimit të mesëm profesional dhe arsimit joformal profesional (zhvillimi i aftësive profesionale - ZHAP); Punësimi i të rinjve, veçanërisht i grave, komunitetit rom, personave me aftësi të kufizuara dhe grupeve të tjera vulnerabël.
Përshkrimi hap pas hapi	<p>Përfaqja e Programit është një qasje sistematike, duke përdorur qasjen e Zhvillimit të Sistemeve të Tregut (ZHST). Përmes qasjes së ZHST-së, ekipi i Helvetas nuk zbaton aktivitete në mënyrë të drejtpërdrejtë por mbështet aktorët (në këtë rast Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, institucionet arsimore, dhomat e tregtisë, shoqatat e ndryshme) përmes ekspertizës dhe/ose ndihmës financiare në mënyrë që ato të arrijnë rezultatet e dëshiruara në mënyrë të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.</p> <p>Bashkëpunëtorët kryesorë përfshijnë institucionet shtetërore në përgjithësi, organizatat e shoqërisë civile (OSHC-të), dhomat e tregtisë, organizatat dhe institucionet zvicerane dhe ndërkombëtare.</p> <p>Komponentët e programit janë si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mbështetje për partnerët në ofrimin e trajnimeve për punësim, të përshtatura me nevojat e tregut; - Krijimi i partneriteteve ndërmjet shkollave të mesme profesionale dhe bizneseve në mënyrë që programet edukative të jenë në përputhje me tregun dhe studentët të kenë mundësinë të zhvillojnë aftësitë praktike; - Përmirësimi i masave të tregut aktiv të punës në mënyrë që ato të jenë më produktive për sa i përket punësimit, më gjithëpërfshirëse dhe më të arritshme për grupet vulnerabël; - Përmirësimi i kuadrit ligjor në mënyrë që ZHAP të jetë më gjithëpërfshirës dhe e orientuar drejt tregut; - Përmirësimi i cilësisë së trajnimit praktik në shkolla dhe biznese të përfshira; - Promovimi i arsimit të mesëm profesional dhe arsimit joformal si mundësi që çojnë drejt punësimit; - Zhvillimi i skemave për rritjen dhe shpërndarjen më të mirë të fondeve për arsimin e mesëm profesional.

Rezultatet	<ul style="list-style-type: none"> - 699 persona të punësuar dhe 1474 persona të trajnuar, nga të cilët 64% janë të rinj, 50% janë gra dhe 12.3% janë grupe vulnerabël (të komunitetit rom dhe persona me aftësi të kufizuara); - “Fondi i Mundësive”, si një masë e orientuar drejt tregut dhe mundësive gjithëpërfshirëse të punësimit e drejtuar nga E4E@MK me një normë punësimi prej 41%, përfshirë në Planin Operacional 2020 së bashku me mekanizmin - pagesë sipas performancës; - “Skema e Garancisë Rinore” ofroi akses në tregun aktiv të punës për 719 të rinj NEET, nga të cilët 469 shfrytëzuan mundësitë dhe 397 përfituan punësim fitimprurës, e përfshirë gjithashtu në Planin Operacional; - Rreth 67 punëdhënës të kategorive të ndryshme u përfshinë në përmirësimin e ZHAP-it joformal dhe AFP-në zyrtar dhe u ofrua mbështetje për 55 oferta të ZHAP - 108 studentë, 10 shkolla të AFP-së dhe 12 biznese u përfshinë në Praktikën Verore në AFP përmes Partneriteteve Publiko-Private, ndërsa 47 mentorë të bizneseve u trajnuan si parakusht për të pritur studentë për Praktikën Verore/Mësimin në lidhje me punën në kompani.
Burimet e disponueshme:	<p>https://www.e4e.mk/en/home/?fbclid=IwAR0wCTgsEXyBhrnlc8eJqspMIWOJmNUHPkc-vd5X-YRHHhbjgkoUVNKC_NY</p>

Lloji i aktivitetit	Trajnim mbi mundësitë për punësim
So-Vet - Sipërmarrja sociale si një alternativë për të rinjtë e papunë - Fondacioni Agro - Qendra për Edukim	
Emërtimi: nëngrup/NEET, OSHC etj.	Të rinjtë, me fokus të veçantë tek të rinjtë NEET
Objektivat e aktivitetit	<ul style="list-style-type: none"> - Përmirësimi dhe rritja e formimit profesional dhe trajnimi mbi sipërmarrjen sociale; - Ofrimi i kurseve efektive dhe efikase për sipërmarrjen sociale; - Rritja e pjesëmarrjes dhe aktivizimit të të rinjve për sa i përket sipërmarrjes sociale; - Ulja e nivelit të papunësisë tek NEET
Përshkrimi hap pas hapi	<ul style="list-style-type: none"> - Identifikimi dhe analiza e nevojave për arsim dhe formim profesional AFP-në dhe sipërmarrjen sociale në Maqedoninë e Veriut; - Hartimi i Kurrikulës dhe Manualit për Sipërmarrësit e Rinj - njohuritë dhe aftësitë që pritet të fitojnë të rinjtë, standardet e të nxënimit ose objektivat e të nxënimit që pritet të përmbushin, detyra dhe mësimet që japin mësuesit; detyrat dhe projektet e dhëna studentëve; librat, materialet, videot, prezantimet dhe leksionet e përdorura në një kurs; si dhe testimet, vlerësimet dhe metodat e tjera të përdorura për të vlerësuar të nxënimit e studentëve; - Programi pilot për të rinjtë që nuk kanë kualifikime dhe/ose përvojë pune; - Zhvillimi i mësimet përmes platformave në internet.
Rezultatet	<ul style="list-style-type: none"> - Një raport analize në çdo vend për të përcaktuar situatën ekzistuese në lidhje me arsimin dhe formimin profesional dhe kurset ekzistuese për sipërmarrjen sociale. - Kurrikula e përgatitur për Sipërmarrësit e Rinj që i referohet njohurive dhe aftësive që pritet të fitojnë të rinjtë, standardeve të të nxënimit ose objektiveve të të nxënimit që pritet të përmbushin, njësive dhe mësimet që japin mësuesit; detyrave dhe projekteve të dhëna studentëve; librave, materialeve, videove, prezantimeve dhe leksioneve të përdorura në një kurs; si dhe testimeve, vlerësimeve dhe metodave të tjera të përdorura për të vlerësuar të nxënimit e studentëve; - Zbatimi pilot i Kurrikulës së Sipërmarrësve të Rinj, me të rinj pa kualifikime zyrtare dhe/ose përvojë pune. - Kursi i platformës së mësimet në internet u zhvillua për nevojat e projektit, të cilin të rinjtë e papunë mund ta ndjekin në internet
Burimet e disponueshme:	https://athena.entre.gr/en/courses/social-entrepreneurship-for-young-unemployed

Lloji i aktivitetit	Zhvillimi i aftësive
Start-Up Factory - Legis	
Emërtimi: nëngrup/NEET, OSHC etj.	Të rinjtë, migrantët dhe refugjatët
Objektivat e aktivitetit	Përmirësimi i mundësive për punësim, sipërmarrje dhe zhvillim i karrierës për të rinjtë.
Përshkrimi hap pas hapi	<ul style="list-style-type: none"> - Projektimi dhe mbajtja e trajnimit për ndërtimin e kapaciteteve për sipërmarrjen sociale; - Zhvillimi dhe ndërmarrja e iniciativave të sipërmarrjes sociale; - Trajnim për ngritjen e kapaciteteve për punëtorët në moshë të re;
Rezultatet	<p>Pjesëmarrësit ishin në gjendje të mësonin se si të kalonin nëpër procesin e zhvillimit të projekteve të sipërmarrjes sociale dhe të reflektonin mbi hapat e ndryshëm të saj; për të kuptuar se si hartohen projektet e sipërmarrjes sociale dhe për t'i bërë ato të përshtatshme për nevojat e migrantëve dhe refugjatëve në moshë të re; për të rritur njohuritë mbi historikun e sipërmarrjes sociale (teori, koncepte, veprime, filozofi); për të zhvilluar aftësitë praktike në hartimin dhe zbatimin e projekteve të sipërmarrjes sociale.</p> <p>Veprimi rriti gjithashtu ndërgjegjësimin në lidhje me problemet që po përjetojnë të rinjtë migrantë dhe refugjatë. Gjatë zbatimit, punëtorët në moshë të re u njohën gjithashtu me mjetet e nevojshme se si të gjejnë mënyra novatore për trajtimin e problemeve sociale në lidhje me të rinjtë migrantë dhe refugjatë, si dhe për të pajisur punëtorët në moshë të re me aftësitë përkatëse se si ata mund të përballen me problemet sociale të të rinjve migrantë dhe refugjatë në shoqërinë e tyre. Aktiviteti kryesor ishte një kurs 7 ditor me 23 pjesëmarrës nga 8 shtete që u zhvillua në Dojran, në Maqedoninë e Veriut.</p>
Burimet e disponueshme:	http://www.legis.mk/news/2755/start-up-factory

Lloji i aktivitetit	Zhvillimi i aftësive
---------------------	----------------------

Rinia Digjitale “MladiHub” - Këshilli kombëtar rinor i Maqedonisë

Emërtimi: nëngrup/NEET, OSHC etj.	Rinia në përgjithësi, veçanërisht rinia NEET në Maqedoninë e Veriut
Objektivat e aktivitetit	Dhënia e aksesit ndaj të rinjve në trajnimin digjital dhe në atë për aftësi biznesi në këmbim të shërbimit komunitar.
Përshkrimi hap pas hapi	Ofrimi i trajnimeve, siç janë: Ms Office, Shkenca e të Dhënave, Programues i ndërfaqes së internetit, Testimi i softuerit, shitjet dhe aftësitë mbi shitjet, aftësitë komunikuese, menaxhim projekti, Adobe Photoshop, marketing digjital etj. Shërbimet e komunitetit, siç janë: Gatimi dhe shpërndarja e vakteve për kategoritë sociale vulnerabël, pastrimi dhe pyllëzimi i hapësirës publike, shkrimi dhe redaktimi i artikujve të Wikipedia në gjuhën maqedonase, prodhimi dhe dhurimi i maskave mbrojtëse, ofrimi i mbështetjes për organizatat jofitimprurëse në lidhje me logjistikën e ngjarjeve, krijimi i dizajnëve, faqeve të internetit, bërja e përkthimeve, etj., kujdesi për kafshët e rrugës, etj.
Rezultatet	Rreth 900 të rinjve iu krijua mundësia për të zhvilluar aftësitë e tyre të biznesit dhe digjitale dhe të angazhohen në aktivitete të shërbimit të komunitetit; Fuqizimi i të rinjve mbi rëndësinë e shërbimit të komunitetit; Përmirësimi i bashkëpunimit ndërsektorial midis institucioneve publike dhe organizatave të shoqërisë civile.
Burimet e disponueshme:	http://www.nms.org.mk/mladihub-digital-youth/?lang=en

Lloji i aktivitetit	Udhëzim dhe këshillim karriere
---------------------	--------------------------------

Përmirësimi i aftësive të punësimit të grupeve vulnerabël në Prilep

Emërtimi: nëngrup/NEET, OSHC etj.	Të rinjtë në përgjithësi, veçanërisht të rinjtë e komunitetit rom
Objektivat e aktivitetit	Përmirësimi i aftësive të punësimit midis grupeve vulnerabël, me fokus komunitetin rom.
Përshkrimi hap pas hapi	<ul style="list-style-type: none"> - Takime në terren me grupet e synuara; - Trajnim i stafit për zbatimin e metodologjisë ACCEDER; - Seancat fillestare individuale dhe vlerësimi i kapaciteteve individuale mbi punësimin; - Udhëzime dhe këshillime për punësimin dhe karrierën; - Zhvillimi i programit të trajnimit dhe ndjekja e programit të këshillimit. <p>Mundësitë e punësimit dhe ndjekja e progresit në vendin e punës.</p>
Rezultatet	Rezultatet kryesore, duke përfshirë këtu metodologjinë ACCEDER që njihet nga kategoritë vulnerabël si një mundësi për të përmirësuar aftësitë e tyre të punësimit. Njohuritë dhe aftësitë e të rinjve të komunitetit rom (me arsim të ulët) janë përmirësuar dhe integruar me sukses në tregun e punës. Së fundmi, u prezantua një partneritet i ri strategjik me sektorin e biznesit privat i cili ka rritur mundësitë e punësimit për të rinjtë e komunitetit Rom.
Burimet e disponueshme:	https://www.sega.org.mk/mk/about-us/projects/item/108-enhancing-employability-skills-of-vulnerable-groups-in

Lloji i aktivitetit	Program trajnimi
Qendra për Aktivizëm Rinor KRIK në bashkëpunim me Unionin e skautëve të Maqedonisë	
Emërtimi: nëngrup/NEET, OSHC etj.	Të rinjtë në përgjithësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë të rinjve me aftësi ndryshe, të cilët përballen me nivele të larta papunësie
Objektivat e aktivitetit	<ul style="list-style-type: none"> - Stimulimi i përfshirjes sociale të fëmijëve me aftësi ndryshe dhe bashkëmoshatarëve të tyre; - Ofrimi i hapësirave për aktivitete të përbashkëta për fëmijët me aftësi ndryshe dhe fëmijët me zhvillim tipik bazuar në arsimin joformal; - Përmirësimi i aftësive sociale të fëmijëve me aftësi ndryshe për mundësi pune në të ardhmen.
Përshkrimi hap pas hapi	<ul style="list-style-type: none"> - Projektimi dhe zhvillimi i programeve të trajnimit për të rinjtë mbi aftësitë e punësimit; - Organizimi i kampeve në natyrë për të rinjtë;
Rezultatet	Janë zhvilluar 10 programe rinore për fëmijët lidhur me përmirësimin e aftësive të tyre të punësimit, kalimin e kohës në mjedise mësimore gjithëpërfshirëse dhe krijimin e lidhjeve me bashkëmoshatarët e tyre.
Burimet e disponueshme:	http://krik.org.mk/wp-content/uploads/2018/05/Publication-See-You-Watching-Me.pdf

Lloji i aktivitetit	Trajnim për aftësitë e punësimit
---------------------	----------------------------------

Programi i Punësimit të të Rinjve “Fillimi i Shkëlqyer i Karrierës”

Emërtimi: nëngrup/NEET, OSHC etj.	Të rinjtë në përgjithësi dhe komuniteti rom nga mosha 15 deri 18 vjeç
Objektivat e aktivitetit	Reduktimi i papunësisë duke ofruar mundësi për bizneset që të kontaktojnë të rinjtë, t'u sigurojnë atyre njohuri shtesë dhe t'i përfshijnë ata në forcën e tyre punëtore; Dhënia e mbështetjes ndaj të rinjve për të kapërcyer pengesat e punësimit duke u ofruar atyre aftësi, përvojë dhe mundësi për të hedhur hapin e parë të suksesshëm në karrierën e tyre.
